ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-24-9646-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Sistemi i Alarmit në AKSP**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Smartech Systems L.L.C.**
NUI	**811949140**
Adresa	**Rr. Mentor Lleposhtica 1900**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Anyle Dermaku**
Adresa elektronike	**info@smartech-systems.net**
Data e parashtrimit të ankesës	**12.04.2025**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Sistemi i Alarmit në AKSP

Sistemi i alarmit në AKSP; me nr. të prokurimit: 214-24-9646-1-2-1;

1. Njoftimi për kontrate i datës 17.09.2024;

2. Dosja e tenderit e datës 17.09.2024;

3. Njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 26.03.2025 së bashku me letrën standarde për eleminim;

4. Kërkesa për rishqyrtim e datës 01.04.2025

5. Vendimi i AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i datës 02.04.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

Eshte derguar procesverbali i hapjes

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Nuk kane ofruar asnje deshmi apo arsyetim per refuzimin e kerkeses per rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit,

dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 – Qëllimi

Neni 6 – Ekonomiciteti

Neni 7 – Barazia në trajtim/ jo-diskriminimi

Neni 52 - Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

Neni 59 – Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

Neni 60 – Kriteret e dhënies

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Rregullorja nr. 001/2022, për Prokurim Publik
Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
Udhëzuesi për Prokurim Publik nr. 001/2023
Neni 10 Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

Neni 30 Validiteti i Tenderit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kënaqur me njoftimin B58 te datës 26.03.2025 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues: AKSP ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Sistemi i alarmit në AKSP; me nr. të prokurimit: 214-24-9646-1-2-1; në afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve dhe duke besuar që nuk eshte respektuar vendimi i OSHP-se me nr 2024/1138 , lëshimet gjatë vlerësimit ishin jo të qëllimshme dhe të ndodhur nga moskujdesi i duhur gjatë vlerësimit të ofertave, kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pran AK-së me datën 01.04.2025 e cila është refuzuar përmes Vendimit nga AK me datën 02.04.2025, bazuar në këto fakte dhe brenda afateve kohore ligjore

parashtrojmë:

ANKESË

Fillimisht shprehim shqetësimin tonë dhe kërkojmë nga OSHP si institucioni më i lartë i prokurimit publik në Kosovë të ushtrojë ndikimin e saj tek AK-të që të mos refuzojnë kërkesat për rishqyrtim pa ofruar asnjë sqarim dhe asnjë fakt.

Autoriteti Kontraktues – Sistemi i alarmit në AKSP; me nr. të prokurimit: 214-24-9646-1-2-1;me rastin e eleminimit tonë ka bërë shkeljet e lartcekura.

Pretendimet tona për shkeljet e lartcekura gjatë vlerësimit janë:

-AK-AKSP me datën 26.03.2024 përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar si pjese e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues na ka njoftuar se jemi eliminuar për arsye: "*GST Sh.p.k & Smartech Systems L.L.C – është i papërgjegjshëm pasi që i mungojnë: zgjatja e validitetit te ofertës për 60 ditë. Kërkesa e autoritetit kontraktues për herën e pare ka qenë me datë 27.12.2024 të zgjatet afati i ofertës deri me 03.01.2025 ndersa O.E. e ka dërguar me 05.01.2025 në kundërshtim me kërkesën e AK-së mbas afati.*

Ne nuk pajtohemi me këtë vendim pasi që konsiderojmë që është i pabazë për arsye:

AK nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së me nr.2024/1138 që bazuar ne LPP është obligativ të respektohet nga AK.

Sa i përket pretendimit të eliminimit tonë shkelja ka ndodhur na vet AK pasi q*ë ka kërkuar zgjatjen e afatit të validitetit të ofertës me më shumë se 2 javë vonesë. Pra nga data 11.12.2024 deri me datën 27.12.2024 nuk ka kërkuar zgjatjen e afatit, ndërsa kërkesa me datën 27.12.2024 ka qenë ditë e Premte dhe në fund vite ku një pjese e madhe e stafit kanë qenë në pushim dhe menjëherë pas fillimit të punës me datën 05.01.2025 kemi dërguar zgjatjen e validitetit të ofertës. Dhe pikërisht në atë kohë ne kemi pasur ankese në OSHP dhe është më se e kuptueshme që kemi qëndruar prapa ofertës sonë përderisa kemi depozituar ankese në OSHP për eliminimin tonë të padrejtë që është vërtetuar edhe nga OSHP. Andaj për lëshimet e AK-së konsiderojmë që nuk mund të penalizohemi ne si operatorë ekonomik. Mos kërkesa në kohe për zgjatje te afatit është shkelje e rende nga ZPP bazuar në Rregulloren e Prokurimit Publik dhe jo shkelje nga OE për tu eliminuar.*

Si dhe anulimi i procedurës për mungese te buxhetit pas vendimit t*ë OSHP-së që vërteton që oferta jonë është e përgjegjshme konsiderojmë që është shkelje e çdo parimi në prokurim publik, kjo pasi që një anulim i tillë nuk ka asnjë bazë ligjore (ju lutem të cekni se në cilin nen të ligjit jeni bazuar kur keni marr një vendim të tillë), për më tepër projekti ka pasur kohëzgjatje 3 muaj dhe hapja e ofertave është bere me datën 11.10.2024 e që në çdo rast do të kalonte në vitin 2025. Andaj ju duhet të siguroni buxhet për këtë projekt pasi qe edhe kontrata është me poentim te çmimit dhe një anulim i tillë është diskriminues për neve duke pas parasysh që na keni shkaktuar dëme materiale duke përfshirë edhe*

kostot për përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës të cilën e kemi fituar që vërteton që na keni eliminuar pa të drejt.

Shkelja e Nenit 1.

Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në Nenin 1 Qëllimi, paragrafi 1: "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla." Dhe paragrafi 3 "Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji."

Shkelje e të gjitha Parimeve të LPP-së.

Shkelja e Nenit 6 dhe Nenit 7

Neni 7 paragrafi 1: "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente."

Ne nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë pasi që jemi eliminuar p*ër lëshim të AK-së* dhe nuk ka qenë e paraqitur tek kërkesat e D.T dhe Njoftimit për kontrate dhe asnjë njoftim lidhur me buxhetin dhe rrezikun e anulimit.

Shkelja e Nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Në veçanti e paragrafit 4 "***Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. ...***"

Ne jemi eliminuar p*ër arsye të lëshimit të vet AK-së.*

Shkelja e Nenit 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Paragrafi 1 "Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;" duke pasur parasysh që ky ishte kriteri i dhënies në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar pasi që ne jemi eliminuar edhe pse kemi dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin me te ulet.

Bazuar ne provat dhe faktet e prezantuara më larte, konsiderojmë se AK – AKSP, vlerësimin krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave e ka realizuar ne kundërshtim me ligjin për prokurim publik dhe me aktet tjera nënligjore si dhe n*ë kundërshtim me vendimin e OSHP-së me nr.* 2024/1138

Shkelja e Neni 30 Validiteti i Tenderit – Rregullorja e Prokurimit Publik

Neni 30 Validiteti i Tenderit parasheh që nëse OE nuk e vazhdon validitetin te eliminohet por nuk përcakton afat se sa ditë do ti jepen ne dispozicion dhe përderisa kemi dorëzuar vazhdimin e validitetit te ofertës nuk ka asnjë baze ligjore eliminimi jonë. Afati i përcaktuar nga AK jashtëligjshëm ka qene 03.01.2025 (ditë e premte si dhe dite pune pas dy ditëve pushim zyrtar) ndërsa ne kemi dërguar konfirmimin me datën 05.01.2025 (dite e diell), pra edhe pse afati ka qene vetëm 3 dite pune ne kemi dërguar konfirmimin para ditës së 4-te te punës.

Shkelja e Nenit 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

LPP ne nenin 62 nuk e parasheh anulimin e procedures pas hapjes se ofertave me arsyetimin e ofruar nga AK, per munges te buxhetit kur sic kemi sqaruar fillimisht ka pasur buxhet per ofertuesin qe ka pasur cmimin me te lart se ne ndersa per ne me cmim me te ulet nuk ka asnje kuptim qe te mos kete buxhet.

Shkelja e Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Nuk është respektuar LPP me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim duke mos ofruar fakte dhe dëshmi mbi refuzimin.

-

Bazuar ne provat dhe faktet e prezantuara më larte, konsiderojmë se AK – AKSP, vlerësimin krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave e ka realizuar ne kundërshtim me ligjin për prokurim publik dhe me aktet tjera nënligjore.

Bazuar në provat dhe faktet e prezantuara kërkojmë që lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe të obligohet AK që gjatë procesit të rivlerësimit të respektohen LPP dhe aktet nënligjore si dhe kërkesat e Njoftimit për kontrate dhe dosjes se tenderit si dhe praktikat e vendosura nga vendimet e OSHP-së, andaj kërkojmë që OSHP të marr:

V E N D I M

- Te aprovohet si e bazuar, ne tërësi ankesa e OE - GST Sh.p.k & Smartech Systems L.L.C.;

- Anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për anulim dhe lënda të kthehet lënda ne Rivlerësim, ndërsa gjatë rivlerësimit të vlerësohet në përputhje me kriteret e LPP-se, Rregullores së Prokurimit Publik dhe akteve tjera nënligjore dhe ne perputhje me vendimin e OSHP-se te shperblehet me kontrate OE - GST Sh.p.k & Smartech Systems L.L.C.;

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Humbja e një kontrate dhe fitimi i humbur nga ajo kontrate që bazuar në ligjin dhe rregulloren aktuale që janë në fuqi Ne kemi qenë ofertuesi që është dashur të shpërblehemi me kontratë bazuar edhe ne kriterin e dhënies. Si dhe për arsye te mos respektimit të LPP-së janë shfaqur edhe shpenzimet për shërbime te avokatisë.

Shpenzimet per pregatitje te kerkesave per rishqyrtim dhe ankesave ne OSHP per dy here me rradhe

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*